



Viti i XVI-të i Botimit, Nr.1

Qershor 2024

**PROCESI I AKREDITIMIT – NJË KONFIRMIM I OFRIMIT TË
STANDARDEVE TË CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË NË
“ALBANIAN UNIVERSITY” ME NJË EKSPERIENCË TË SHKËLQYER
20-VJEÇARE NË SHQIPËRI.**

Eglantina Merkaç*, Rozarta Nezaj, Elona Zyka*, Erda Qorri***, Aida Dama******

** Departamenti i Inxhinierive, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike,
Albanian University*

***Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore,
Albanian University*

**** Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University*

***** Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University*

Abstrakt

Hyrje: Akreditimi është një proces shumë i rëndësishëm për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së një institucioni të arsimit të lartë. Menaxhimi i cilësisë së arsimit të lartë nuk është një proces i lehtë. Kërkon përpjekje, kohë dhe menaxhim të duhur të të dhënave, mund të shumëfishojë ngarkesën e anëtarëve të fakultetit dhe mbi të gjitha ky proces përfshin stafin, fakultetin, studentët, të diplomuarit dhe bordet këshilluese në vlerësimin institucional, planifikimin dhe krijimin e objektivave për vetë-përmirësimin institucional.

Materiale dhe metoda: Në këtë punim duam të paraqesim procesin e akreditimit të Albanian University, fazat e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm për një periudhë mbi 15 vite. Të dhënat janë mbledhur dhe analizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Rezultatet: “Albanian University” aktualisht numëron 39 programe studimi aktive: 14 Bachelor, 11 Master Profesional, 7 Master i Shkencave, 4 programe Master i Shkencave program i Integruar, 2 Specializim afatgjatë, 1 program me karakter profesional dhe Masteri i ri i përbashkët i Integruar i Shkencave në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës. Të gjitha programet janë të akredituara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimit të Lartë (ASCAL) me një periudhë mesatare akreditimi mbi 3 vjet.

Konkluzione: “Albanian University” bazuar në përmbushjen e standardeve cilësore të arsimit të lartë është vlerësuar pozitivisht dhe akredituar institucionalisht 3 herë nga ASCAL. Ky është një konfir-

mim se AU e udhëhequr nga vlerat dhe e përqendruar te njerëzit, duke përdorur njohuritë e transmetuara tek studentët, duke i motivuar ata të zhvillojnë aftësi kërkimore dhe reflektuese për çështje të rëndësishme të komunitetit kombëtar dhe ndërkombëtar, përmes edukimit cilësor dhe programeve moderne të studimit me qëllim ndryshimin e jetës së tyre të ardhshme si dhe duke kontribuar në këtë mënyrë për një shoqëri produktive dhe të begatë.

Fjalë çelës: *Albanian University, akreditimi, standardet cilësore*

Hyrje

“Albanian University” është një institucion privat, i pavarur, laik dhe me një përvojë 20-vjeçare në Arsimin e Lartë.

“Albanian University” ofron një diversitet diplomash në tre ciklet e studimit dhe programet me karakter profesional, duke qenë koherente me kërkesat e tregut të punës dhe sjelljen e risive në programe të reja studimi. Sot AU është një emër i konsoliduar në arsimin e lartë privat në Shqipëri me numrin më të lartë të studentëve aktivë dhe atyre të diplomuar ndër universitetet privatë. Jemi krenarë për gjeneratat e të diplomuarve, të cilët mbartin kombësi të ndryshme dhe e kanë gjetur veten në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar apo në thellimin e njohurive të tyre akademike.

Në mënyrë periodike, institucioni dhe të gjitha programet aktive të studimit kanë kaluar procesin e vlerësimit të jashtëm nga ASCAL dhe janë vlerësuar pozitivisht nga Bordi i Akreditimit. Mbarëvajtja e këtij procesi dhe realizimi i tij në përputhje me legjislacionin në fuqi është në qendër të veprimtarisë së Institucionit.

Procesi i akreditimit luan një rol kyç në sigurimin e cilësisë së arsimit të lartë dhe siguron që institucionet arsimore dhe programet e tyre të përmbushin kërkesat gjithnjë në zhvillim të sektorit të arsimit dhe tregut të punës.

Agjencitë e akreditimit janë organizata të pavarura që specializohen në vlerësimin e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit. Detyra e tyre kryesore është të sigurojnë që institucionet arsimore të përmbushin disa standarde të cilësisë. Këto agjenci mund të operojnë si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar dhe të japin një kontribut të rëndësishëm në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Sistemi i akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri është ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 303, datë 01.07.1999.

Agjencia e parë e akreditimit është quajtur Agjencia e Akreditimit të Lartë (AAAL), ku vendimet merreshin nga Këshilli i Akreditimit (KA).

Më pas agjencia u quajt Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAL), ku u ndryshua dhe emërtimi i vendimarrëseve nga këshill akreditimi në Bord Akreditimi dhe që nga viti 2017 me VKM ne.109, datë 15.02.2017, agjencia ka marrë emërtimin Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Sigurimi i brendshëm i cilësisë është një detyrim ligjor i institucioneve të arsimit të lartë duke qenë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë [1].

Në “Albanian University”, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksionon që nga viti 2009-2010. Që nga ajo kohë, Universiteti për të institucionalizuar Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të

Cilësisë me Vendim Senati Akademik, Nr.178, datë 23.07.2010, ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, dhe në përputhje me ligjin 80/15 për “Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” [2] [3], me Vendim Nr.4 të Senatit Akademik datë 22.12.2016 ka ngritur edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional. Me qëllim krijimin e kulturës së cilësisë në institucion, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë funksionon edhe në nivel njësie bazë që në Shtator të vitit 2016 me ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë brenda saj, me Vendim Senati Akademik Nr.157/3, dt.08/09/2016 [4]. Struktura dhe funksionet e kësaj njësie përcaktohen në Statutin e “Albanian University”.

Akreditimi është një formë e kontrollit të cilësisë, duke siguruar që institucionet e arsimit të lartë të përmbushin disa standarde. Ky proces përfshin vlerësimin e kurrikulës, metodat e mësimdhënies, kualifikimet e stafit mësimdhënës dhe rezultatet e arritura të të nxënësve [5].

Është një certifikatë formale e lëshuar nga një organ i autorizuar për të konfirmuar që një institucion arsimor ose një program studimi specifik plotëson standardet dhe kriteret e përcaktuara.

Qëllimi i akreditimit është të sigurojë që institucionet e arsimit të lartë të përmbushin nivele të pranueshme të cilësisë .

Ky proces në Shqipëri realizohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL)

Institucionet e Arsimit të lartë i nështrohen dy lloje akreditimesh [6]:

- Akreditimi institucional: i referohet të gjithë institucionit dhe vlerëson institucionin e arsimit të lartë në tërësi, duke përfshirë infrastrukturën, administratën, burimet dhe të gjitha programet e ofruara.
- Akreditimi i programit të studimit: Ky fokusohet në programe specifike studimi brenda një universiteti. Ai kontrollon nëse programet përkatëse të studimit përmbushin standardet akademike të vendosura për disiplinën përkatëse.

Sigurimi dhe përmirësimi i cilësisë: Akreditimi është një instrument i rëndësishëm për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Ai siguron që institucionet arsimore dhe programet e tyre të studimit të përmbushin një standard minimal të cilësisë. Kjo vlen jo vetëm për përmbajtjen e mësimdhënies, por edhe për metodat e mësimdhënies, kualifikimet e stafit mësimdhënës, kushtet e studimit dhe burimet e disponueshme. Rishikimi dhe vlerësimi i rregullt përmes procedurave të akreditimit promovon gjithashtu një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm brenda institucioneve të arsimit të lartë.

Transparenca dhe baza e informacionit: Akreditimi krijon transparencë në sektorin e arsimit. Ai u ofron studentëve të ardhshëm, punëdhënësve dhe palëve të tjera të interesuara një bazë të besueshme informacioni për vlerësimin e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre. Kjo lehtëson vendimmarrjen kur zgjidhni se ku të studioni ose kur rekrutoni të diplomuar.

Njohja ndërkombëtare dhe mobiliteti: Në një botë të globalizuar, njohja ndërkombëtare e diplomave ka një rëndësi të madhe. Programet dhe universitetet e akredituara shpesh gëzojnë një reputacion më të lartë ndërkombëtar, gjë që lehtëson lëvizshmërinë e studentëve dhe të diplomuarve përtej kufijve kombëtarë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fushat me standarde ndërkombëtare profesionale ose kur vazhdoni një karrierë akademike jashtë vendit.

Përafrimi me tregun e punës: Akreditimi ndihmon për të siguruar që programet e studimit të jenë jo vetëm të konsoliduara nga ana akademike, por edhe të plotësojnë nevojat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës. Duke përfshirë ekspertë të industrisë dhe punëdhënës në procesin e akreditimit, mund të zhvillohen kurrikula që i përgatisin në mënyrë optimale të diplomuarit për të ardhmen e tyre profesionale.

Promovimi i inovacionit dhe kërkimit: Standardet e akreditimit shpesh promovojnë gjithashtu aktivitetet kërkimore dhe kapacitetin inovativ të universiteteve. Ato motivojnë institucionet të investojnë në kërkimin dhe zhvillimin, të promovojnë përsosmërinë akademike dhe të përfshijnë gjetjet në mësimdhënie.

Në përgjithësi, akreditimi forcon besimin në arsimin e lartë, promovon standarde të larta arsimore dhe mbështet zhvillimin e programeve të studimit që janë konsoliduara nga ana akademike dhe relevante për praktikën. Prandaj është një faktor vendimtar për cilësinë dhe atraktivitetin e sektorit të arsimit të lartë.

Materiale dhe Metoda

Në këtë punim kemi paraqitur të dhëna për procesin e akreditimit të Albanian University, fazat e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm për një periudhë mbi 15 vite, të cilat janë mbledhur dhe analizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Qëllimi i këtij punimi është të paraqesë vlerësimin ndër vite të “Albanian University” bazuar në standardet e cilësisë për akreditimin e universiteteve [7][8][9].

Standardet për akreditim në përgjithësi mbulojnë aspekte të tilla si:

Kurrikula: Përshtatshmëria, aktualiteti dhe rëndësia e përmbajtjes mësimore.

Fakulteti: kualifikimet dhe përvoja e personelit mësimdhënës.

Burimet mësimore: disponueshmëria e bibliotekave, laboratorëve dhe materialeve të tjera mësimore.

Shërbimet mbështetëse: Këshillim, shërbime karriere dhe mbështetje të tjera studentore.

Kërkimi dhe inovacioni: pjesëmarrja dhe kontributi në kërkimin dhe inovacionin shkencor.

Procesi i akreditimit është një procedurë sistematike që synon rishikimin dhe vërtetimin e cilësisë dhe standardeve të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit dhe duhet të vepohet në përputhje me kërkesat, procedurat dhe udhëzimet e hartuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimit të Lartë [9].

Ky proces ndryshon në varësi të vendit, agjencisë së akreditimit dhe fokusit specifik të akreditimit, por në përgjithësi ndjek këto hapa bazë:

Vetëvlerësimi: Institucioni ose programi i arsimit të lartë që akreditohet kryen një rishikim të brendshëm. Duke bërë këtë, ai vlerëson veten në bazë të kritereve dhe standardeve të përcaktuara nga agjencia e akreditimit. Ky vetëvlerësim zakonisht përfshin një analizë gjithëpërfshirëse të kurrikulave, metodave të mësimdhënies, kualifikimeve të stafit mësimdhënës, burimeve, aktiviteteve kërkimore dhe shërbimeve mbështetëse të studentëve.

1. **Dorëzimi i raportit të vetëvlerësimit (RVB):** Rezultatet e vetëvlerësimit përmbledhen në një raport të detajuar, sipas modelit të përcaktuar nga Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë duke ngritur një grup pune që quhet grupi i vlerësimit të brendshëm (GVB), i cili më pas i dorëzohet agjencisë së akreditimit. Ky raport shërben si bazë për vlerësimin e jashtëm [10][11].

2. **Rishikimi i jashtëm:** Agjencia akredituese kryen një rishikim të jashtëm duke caktuar një ekip ekspertësh që vizitojnë universitetin dhe shqyrtojnë informacionin në raportin e vetëvlerësimit. Këta ekspertë kryejnë takime me strukturat përkatëse si dekan, drejtues departamenti, grupin e vlerësimit të brendshëm, studentë dhe personel akademik & administrativ, studentë përgjegjës të zyrave përkatëse

sipas një axhende të përcaktuar më parë dhe vlerësojnë institucionin sipas standardeve të vendosura.

3. Raporti i vlerësuesve të jashtëm (RVJ): Pas vizitës, ekipi i ekspertëve përgatit një raport vlerësimi që identifikon pikat e forta dhe të dobëta të institucionit të arsimit të lartë ose programit të studimit dhe jep rekomandime për përmirësim.

4. Vendimi i akreditimit: Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm, raportin e vlerësimit të ekspertëve dhe çdo përmirësim të nevojshëm, agjencia e akreditimit merr një vendim për akreditimin. Kjo mund të variojë nga akreditimi i plotë (6 vite) deri te akreditimi minimal (1 vit) ose refuzimi i kushtëzuar.

5. Rishikim i vazhdueshëm: Akreditimi nuk është një proces i vetëm, por një proces i vazhdueshëm i përmirësimit të cilësisë. Programet dhe institucionet e akredituara duhet të rivlerësohen në intervale të rregullta për të rinovuar akreditimin e tyre.


Rezultate dhe Diskutime

Aspektet kryesore të vlerësimit në arsimin e lartë janë [12]:

1. Misioni dhe objektivat e një institucioni të arsimit të lartë, programi dhe kurrikulat etj.
2. Struktura organizative e IAL-ve, njësitë përbërëse të tyre dhe procesi i menaxhimit të tyre;
3. Analiza e kurseve të studimit, diplomave dhe MSc etj;
4. Programet e studimit, organizimi i kurrikulave, kreditet;
5. Personeli akademik dhe administrativ;
6. Mësimdhënia;
7. Kërkimi shkencor;
8. Të diplomuarit;
9. Objektet, burimet materiale, baza logjistike dhe shërbime të tjera që i ofrohen komunitetit;
10. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare;
11. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë;
12. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun dhe tregun e punës.

Për realizimin e këtij punimi janë analizuar disa të dhëna, të cilat demostrojnë disa tregues matës për vlerësimin e cilësisë. Mbledhja, analizimi dhe përpunimi i të dhënave për nxjerrjen e rezultateve të mëposhtme janë realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në “Albanian University”.


1. Kohëzgjatja e akreditimit institucional në vite



Grafiku nr.1

Sic vërehet edhe nga grafiku nr.1 kohëzgjatja e akreditimeve institucionale ka ardhur në rritje nga 2 vite në vitin në 2017 në 3 vite në 2020 dhe 4 vite në 2023, duke dëshmuar dhe vërtetuar rritjen e nivelit të cilësisë së mësimdhënies në institucionin e lartë arsimor Albanian University e konfirmuar kjo nga vizitat vlerësuese të jashtme të realizuara nga ekspertët e ASCAL.

2. Kohëzgjatja mesatare e akreditimive për fakultet



Grafiku nr.2


Sic vërehet edhe nga grafiku i mësipërm për Fakultetin e Shkencave Mjekësore kohëzgjatja mesatare e akreditimeve për të gjitha programet është 3.5 vite. Ku vendin e parë e zë programi Master i Integruar i Shkencave në Stomatologji me 4.5 vite, programi i parë, i cili i ka hapur dyert për studentët e

parë në vitin 2004, vit, i cili përkon dhe me hapjen e institucionit.



Grafiku nr.3

Siç vërehet edhe nga grafiku nr.3 për Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, kohëzgjatja e mesatare e akreditimit është 3.6 vite. Vlerësimin e larë në vite (5) e kryesojnë programet Bachelor në Inxhinieri (BSc. Teknologji Informacioni; BSc. Inxhinieri Elektronike dhe BSc. Inxhinieri Kompjuterike, për t'u ndjekur më pas nga Bachelor në Financë- Bankë, MSc. Menaxhim Bankar dhe MP. Interior Dizajn me nga 4 vite.




Grafiku nr.4

Për Fakultetin e Shkencave Shoqërore, i cili ofron ofron 13 programe studimi, nga grafiku nr. 4, vërehet se mesatarja e kohëzgjatjes së akreditimeve është 3.4 vite, duke marrë në konsideratë mesataren e të gjithë programeve të studimit.

*BSc. Shkenca Juridike është riorganizuar nga program i ciklit të parë në program i integruar i ciklit të dytë “Drejtesi” me Urdhër nr. 188, datë 03.07.2020.

3. Programet aktive në AU




Grafiku nr.5

“Albanian University” aktualisht numëron 39 programe studimi aktive: 14 Bachelor, 11 Master Profesional, 7 Master i Shkencave, 4 programe Master i Shkencave program i Integruar, 2 Specializim afatgjatë, 1 program me karakter profesional dhe Masteri i ri i përbashkët i Integruar i Shkencave në bashkëpunim me Universitetin e Ferrarës.

Siç vërehet nga grafiku nr.5 Shpërndarja në përqindje për secilin nivel programi është:

- 36% programet Bachelor (BSc)
- 28% programet e ciklit të dytë Master Profesional (MP)
- 18% programet e ciklit të dytë Master i Shkencave (MSc)
- 10% programet Master i Integruar i Shkencave (PIND)
- 5% programet e ciklit të tretë Specializime Afatgjata (SPA)
- 3% program me karakter profesional



Grafiku nr.6

“Albanian University” themeluar në përputhje me legjislacionin në fuqi me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 197, datë 10.04.2004 “Për dhënien e lejes për hapjen e shkollës së lartë universitare jopublike “UFO Dental”. Me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 597, datë 28.5.2009 emërtimi i shkollës së lartë universitare, private “UFO dental” ndryshon në “UFO University”.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 603, datë 24.8.2011 u vendos ndryshimi i emrit të universitetit privat nga “UFO University” në “Albanian University”, emër të cilin e mban dhe sot.

“Albanian University” hapi dyert në vitin akademik 2004 - 2005, me kursin e parë të studimeve të Stomatologjisë, me rreth njëqind studentë. Siç vërehet nga grafiku nr.6 ndër vite në Universitet numri i të regjistruarëve ka patur shifra të larta mesatarisht 1608 studentë. Ku ndër vitet që kanë kulmuar numrin e të regjistruarëve në AU janë:

- ❖ v.a 2014-2015 me 3279 të regjistruar
- ❖ v.a 2016-2017 me 2851 të regjistruar

Me një eksperiencë 20 vjeçare në tregun e Arsimit të Lartë jopublik, “Albania University”, renditet ndër të parët për numrin e lartë të studentëve ndër vite.

Konkluzione

Akreditimi është i rëndësishëm sepse:

- Ndhmon në përcaktimin nëse një institucion përmbush ose tejkalon standardet minimale të cilësisë.
- Ndhmon studentët të përcaktojnë institucionet e pranueshme për regjistrim.
- Të ndihmojë institucionet në përcaktimin e pranueshmërisë së transfertave të krediteve.
- Ndhmon punëdhënësit të përcaktojnë vlefshmërinë e programeve të studimit dhe nëse një i diplomuar është i kualifikuar.
- Punëdhënësit shpesh kërkojnë dëshmi se aplikantët kanë marrë një diplomë nga një shkollë ose program i akredituar.
- U mundëson të diplomuarve të hyjnë në provimet e certifikimit.
- Përfshin stafin, fakultetin, studentët, të diplomuarit dhe bordet këshilluese në vlerësimin dhe planifikimin institucional.
- Krijon synime për vetë-përmirësim institucional.

Rëndësia e akreditimit në sistemin arsimor shtrihet shumë përtej konfirmimit të thjeshtë të standardeve të cilësisë. Është një shtyllë qendrore në sigurimin e cilësisë së arsimit, promovimin e inovacionit dhe njohjen ndërkombëtare të arritjeve akademike.

Referenca

1. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë, Dhjetor 2021.
2. Udhëzues për ngritjen dhe funksionimin e NJBSC në IAL, ASCAL.
3. Ligji Nr. 80/2015, Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Kreu X, Sigurimi i Cilësisë në Arsimin e Lartë, neni 103,

- sistemi i brendshëm i cilësisë.
4. Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në “Albanian University”.
 5. <https://www.munich-business-school.de/en/l/university-glossary/accreditation-for-universities>.
 6. <https://www.linkedin.com/pulse/ëhy-you-should-apply-accredited-university-edugate-eg>
 7. <https://ascal.al/media/documents/standardet/Standardet-per-programet-e-studimit-te-ciklit-te-pare-Bachelor.pdf>
 8. <https://ascal.al/media/documents/standardet/Standardet-per-programet-e-integruara-te-studimeve-te-ciklit-te-dyte-Master-i-Shkencave.pdf>
 9. <https://ascal.al/media/documents/standardet/Standardet-per-programet-e-studimit-me-karakter-profesional.pdf>
 10. Manual , Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017
 11. Udhëzues për “Administrimin e dokumentacionit në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit”
 12. <https://ascal.al/media/documents/publikime/aspektet-dhe-treguesit-e-vleresimit-te-cilesise-ne-arsimin-e-larte.pdf>